

Thirrje për shprehje të interesit: Angazhim në cilësinë e Konsulentit/ës për hartimin e “Analizës së nevojave të Diasporës dhe identifikimi i problemeve”

1. Rreth Organizatës GERMIN

Germin është një organizatë joqeveritare që përdor teknologjinë dhe kanalet virtuale për të lidhur dhe angazhuar Diasporën në avancimin e zhvillimit dhe demokratizimit të vendeve të tyre. Germin filloi në 2011 si një grup joformal që përpqej të gjente rrugën për t'u lidhur me atdheun dhe u themelua zyrtarisht në 2014. Germin drejtohet dhe mbështetet nga një grup profesionistësh të Diasporës duke filluar nga fusha e politikave publike, financave, informacionit, teknologjisë, ligjit, arsimit, sigurisë dhe diplomacisë. Ne kemi një rrjet të gjerë profesionistësh dhe bashkëpunëtorësh me kohë të pjeshme, aktualisht banojnë në 24 vende, përfshirë Ballkanin, Evropën Perëndimore dhe Amerikën e Veriut.

2. Rreth projektit “Angazhimi i Diasporës për Avancimin e Politikbërjes në Kosovë”

Germin është duke implementuar projektin “Angazhimi i Diasporës për Avancimin e Politikbërjes në Kosovë” me mbështetje të Smart Ballkans. Qëllimi parësor i këtij projekti është përmirësimi i proceseve politikë-bërëse në Kosovë, përmes optimizimit të kontributeve të diasporës. Germin synon ta arrijë këtë qëllim përmes dy objektivave kryesore: A) Mbështetja për avancimin e zërit të diasporës - Ky objektivi përfshinë lehtësimin e angazhimit të drejtpërdrejtë të profesionistëve të diasporës në proceset e politikbërjes. Projekti do të shfrytëzojë teknologjitë e reja dhe kanalet virtuale të komunikimit për të siguruar që perspektivat dhe ekspertiza e diasporës të integrohen në mënyrë efektive në iniciativat politikëbërëse. Duke avokuar për përfshirjen e zërit të diasporës, projekti synon të kapërcejë hendekun midis qeverisë dhe komunitetit të diasporës, duke krijuar një proces më gjithëpërfshirës dhe përfaqësues politikbërjeje. B) Përdorimi i aftësive dhe njohurive për zhvillimin e politikave - Ky objektivi fokusohet në përdorimin e aftësive dhe njohurive të profesionistëve të diasporës për të përmirësuar cilësinë e përgjithshme dhe efektivitetin e zhvillimit të politikave dhe legjisllacionit. Projekti synon të përmirësojë proceset gjithëpërfshirëse për zhvillimin e politikave duke ofruar hulumtime, dizajnim të politikave dhe ekspertizë për rrjetëzim për Kuvendin e Kosovës. Duke shfrytëzuar kapitalin njerëzor të komunitetit të diasporës, projekti synon të përmirësojë kapacitetin e institucioneve politikëbërëse në Kosovë për të krijuar dhe zbatuar politika efektive në funksion të qytetarëve.

3. Objektivat e thirrjes

Analiza e Nevojave të Diasporës dhe Identifikimi i Problemeve - Një analizë e detajuar e nevojave të diasporës do të bëhet për të identifikuar sfidat kryesore me të cilat përballet ky komunitet dhe për të ofruar zgjidhje efektive. Kjo analizë do të jetë e lidhur ngushtë me aktivitetet e tjera të projektit, me fokus të veçantë në të drejtat e përfaqësimit dhe pjesëmarrjes, si dhe çështjet që lidhen me Strategjinë Kombëtare të Diasporës dhe Ligjin për Diasporën. Gjetjet e kësaj analize do të përmbledhen në një raport të detajuar. Ky dokument do të sigurojë njohuri të vlefshme dhe do të informoj zhvillimin e politikave efektive për adresimin e sfidave me të cilat përballet diaspora.

4. Kërkesat specifike të përmbajtjes së Analizës

1. Hartimi i një dokumenti përmbajtësor i cili paraqet analizën e nevojave të Diasporës karshi politikbërjes në Kosovë
2. Identifikimi i të pakën 5 sfidave të komunitetit të diasporës
3. Hartimi i të paktën 5 rekomandimeve (për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës si dhe Komisionin Parlamentar për Punë të Jashtme dhe Diasporë) në bazë të sfidave të identifikuar
4. Rekomandime për zhvillimin e politikave efektive për adresimin e sfidave me të cilat përballlet diaspora
5. Dokumenti final të përfundohet gjatë muajit nëntor 2023

5. Përgjegjësitë e Konsulentit/ës

1. Hulimtimi mbi nevojat e Diasporës dhe identifikimi i problemit rreth sfidave të tyre si shkak i politikbërjes në Kosovë
2. Analizimi i vendimeve/punës së Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës si dhe Komisionit Parlamentar për Politikë të jashtme dhe Diasporë, si dhe ndikimi i vendimeve/punës tek diaspora shqiptare
3. Hartimi i rekomandimeve për dy institucionet e lartcekura
4. Përgatitja e draftit dhe dërgimi tek GERMIN për komente
5. Adresimi i komenteve eventuale në bazë të kërkesës

6. Kriteret të cilat duhet të plotësohen për angazhim në cilësinë e Konsulentit/ës.

1. Të kenë përvojë në hulimtim
2. Të jenë të familjarizuar me punën me Diasporën
3. Të jenë në gjendje të sigurojnë të paktën 2 referenca për angazhim në cilësinë e konsulentit/ës në të kaluarën
4. Të kenë njohuri për politikë-bërje në Kosovë, specifikisht për institucionet si: Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës dhe Komisionin Parlamentar për Punë të Jashtme dhe Diasporë.

7. Dokumentet e kërkuara dhe procedura e aplikimit

1. Oferta financiare në përputhje me ditët (7) totale të punës të kërkuara
2. Të paktën dy referenca të punëdhënësve të mëparshëm
3. Dëshmi të punës në shkrim të analizave/hulumtimeve
4. CV e cila dëshmon angazhimin në fusha/detyra të ngjashme
5. Dokumentet e kërkuara në pikën shtatë të këtij ToR të dërgohen në adresën elektronike apply@germin.org - subject: Shprehje të interesit: Angazhim në cilësinë e Konsulentit/ës për hartimin e "Analiza e nevojave të Diasporës dhe identifikimi i problemeve"
6. Data e fundit për aplikim **10 nëntor 2023, ora 23:59 (CET)**

Kjo thirrje është zhvilluar me mbështetjen e projektit rajonal "SMART Balkans – Shoqëria Civile për Vlera të Përbashkët në Ballkanin Perëndimor" të zbatuar nga Centar za promociju civilnog društva (CPCD) në bashkëpunim me Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM), dhe Qendra për Kërkim dhe Politikëbërje (CRPM) dhe i mbështetur financiarisht nga Ministria e Punëve të Jashtme të Norvegjisë (NMFA). Përmbajtja e kësaj thirrje është përgjegjësi vetëm e GERMIN si zbatues i projektit dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Ministrisë së Punëve të Jashtme Norvegjeze (NMFA)